

## SOCIALIZIMI TEK FËMIJET ME PRINDËRIN BABA TË DËNUAR

JULIANA AJDINI

Universiteti të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Politikës dhe Punës Sociale  
jajdini@gmail.com

AKTET V, 4: 564 - 573, 2012

### PERMBLEDHJE

Ky artikull synon të kontribuojë në rritjen e interesit dhe konsideratës për efektet e dënimit të babait tek fëmijët duke adresuar çështje të reja të praktikës së punës sociale. Prezantimi i një panorame të përgjithshme të socializimit dhe teorieve të tij do të jetë fokus i këtij artikulli. Në artikull do të paraqitet një studim me 10 fëmijë me baba të dënuar. Metoda kërkimore ka qenë ajo cilësore. Ky artikull ka arritur dhe në disa gjetje dhe konkluzione. Kështu, dënimi i babait ndikon drejtpërdrejtë në socializimin e fëmijëve, në mënyrën se si i perceptojnë marrëdhëniet me veten dhe te tjerët. Vete fëmijët shprehin se statusi i tyre përcakton dhe vendin në shoqëri duke nxitur diskriminimin e tyre. Një nga rekomandimet më të rëndësishme të këtij artikulli qëndron në faktin e rritjes së ndërgjegjësimit të politikë-bërësve për të adresuar më mirë nevojat dhe të drejtat e fëmijëve me baballarë të dënuar.

**Fjalët kyçe:** fëmijë, fëmijë me baballarë të dënuar, socializim, punë sociale.

### SUMMARY

A This article aims to contribute to the growing interest and consideration for the effects of punishment on children's father addressing new issues in social work practice with this social group. Presentation of an overview of theories of socialization it will be also the focus of this article. The article will present a study with 10 children with a convicted father. The method has been that qualitative research. This article has achieved and in some findings and conclusions. Thus, father's conviction directly affects the socialization of these children, in how they perceive themselves and relationships with others. Children themselves say that their status, with fathers convicted, defines their place in society by promoting discrimination against them. One of the most important recommendations of this paper is that of increasing awareness of policy makers to better address the needs and rights of children with fathers convicted.

**Key words:** children, children with convicted father, socialization, social work

---

### I. HYRJE

Përqindja e prindërve, për gratë si dhe burrat, në popullsinë e burgjeve po rritet nga viti në vit. Një studim i kohëve të fundit nga Instituti i Statistikave të Sistemit të Drejtësisë në ShBA (1991) zbuloi se rreth dy të tretat e grave të dënuara dhe më shumë se gjysma e burrave të dënuar janë prindër të fëmijëve nën moshën 18 vjeç. Rreth 2/3 (58.8 %) e grave në burgje dhe me pak se gjysma (45.3%) e grave në paraburgime kanë fëmijë nën moshën 18 vjeç. Të dhënat për baballarët e dënuar janë akoma dhe më të larta –

respektivisht 63.4 % dhe 54.7 % (Mumola 2000). Fëmijët e tyre numëroheshin në rreth 1.5 milion në vitin 1999, dhe janë në një rrezik të lartë për tu përfshirë në probleme me natyrë sjellore dhe emocionale (Lowenstein 1986). Delikuenca rinore, agresioni, frika, ankthi, mërzitja, vetmia, fajësimi, vetë-vlerësimi i ulët, depresioni, performanca e ulët akademike, dhe luhatjet emocionale janë përjetimet më të shumta e më të shpeshta të fëmijëve të të dënuarve (Covington and Katz 1997).

Fëmijët me baballarë të dënuar kanë nevoja të shumta dhe imediate. Ata kanë nevojë për një vend të sigurt për të jetuar dhe njerëz që të kujdesen për ta në mungesë të babait të tyre, sikurse edhe për gjithçka tjetër që një baba duhet të sigurojë për fëmijët e tij: afekcion, ushqim, veshje, kujdes mjekësor, etj. Studimet kanë treguar se kjo kategori fëmijësh përjetojnë një sërë ndjenjash si: frikë, zemërim, faj, përjetojnë ankth, ndjehen të braktisur dhe të vetëm (Block & Potthast, 1998). Disa nga këto fëmijë shfaqin sjellje problematike dhe agresive në shkollë, shtëpi dhe në komunitet, ndërsa disa të tjerë mbyllen në vetvete dhe bëhen depresivë (Hunter, 1980). Kërkimet e mëparshme (jo në Shqipëri) tregojnë se shumë nga këta të rinj janë shumë të rrezikuar për të vazhduar ciklin e burgosjes të filluar nga baballarët e tyre (Mumola, 2000).

Ky realitet të zymtë duhet të përbëjë një shqetësim të madh politik, sepse burgimi i prindërve, qoftë edhe njërit prej tyre, mund të ketë pasojë të rënda në rënien e kapitalit ekonomik dhe social, nga të cilat varet suksesi i familjeve dhe komuniteteve për të rritur të vegjlit e tyre (Hagan, 1994).

Ndryshimet në mirëqenien e fëmijëve të prindërve të dënuar bëhen veçanërisht të dukshme gjatë tranzicionit nga adoleshenca në moshën e rritur. Gjatë kësaj periudhe ata mund të përfshihen jo vetëm në sjellje antisociale, por edhe në braktisje të shkollës, marrëdhëniet seksuale të pambrojtura, braktisje e shtëpisë dhe mungesë dëshire për të punuar. Shenjat e problemeve të tilla fillojnë dhe shfaqen që në fëmijërinë e hershme.

Burgimi i babit shkakton kaos në jetën e fëmijëve. Teoritë sociologjike dhe ato kriminologjike theksojnë tri momente kyçe si efekte të drejtpërdrejta tek fëmijët: deprivimin ekonomik, humbjen e socializmit prindëror nëpërmjet rolë-modelit; mbështetjes dhe supervizimit; dhe stigmën dhe turpin nga etiketimet shoqërore (Hagan, 2000).

Shumë pak studime i kanë kushtuar vëmendje pasojave psiko-sociale të dënimit të babait për familjet dhe fëmijët. Në Shqipëri, fatkeqësisht mungojnë të dhënat e sakta për numrin apo

kushtet në të cilat jetojnë fëmijët me baballarë të dënuar. Ky studim, i pari i tillë në Shqipëri, sjell në vëmendjen e studiuesve, nevojat e fëmijëve që kanë babain të dënuar. Në këtë mënyrë synohet të hapet një fushë e re studimi që kërkon vëmendjen e e profesionistëve të punës sociale, dhe jo vetëm.

**Qëllimi i këtij artikulli** është eksplorimi nëpërmjet eksperiencave të vetë fëmijëve me baba të dënuar se si ka ndikuar ai në socializimin e tyre. Prezantimi i teorive të socializmit dhe efektet e dënimit të babit tek fëmijët do të jenë gjithashtu fokus i këtij artikulli.

**Objektivat e këtij studimi** do të jenë:

- Eksplorimi i disa faktorëve që ndikojnë në socializmin e fëmijëve me baba të dënuar në Shqipëri.
- Prezantimi i teorive kryesore të socializmit të fëmijëve me baba të dënuar.

**Pyetjet kërkimore** të këtij studimi do të jenë:

- Si e perceptojnë socializmin e tyre, fëmijët baba të dënuar?
- Çfarë ndryshimesh në konceptin e socializimit kanë ndodhur në jetën e fëmijëve pas dënimit të babait të tyre?

## II. METODOLOGJIA

Ky studim ka në thelb metodën shkencore cilësore e cila nuk bazohet në kampionim të popullatës. Do ishte ideale që kërkuesja të arrinte që të studiojë të gjithë fëmijët me baballarë të dënuar. Por kjo në një situatë reale është pothuajse e pamundur. Rezultatet e këtij studimi nuk mund të përgjithësohen në një popullsi të gjerë, por qëllimi i këtij studimi është të kuptuarit në mënyrë të detajuar, të unicitetit të fenomenit që studiohet për ata persona që ishin pjesë e këtij studimi.

### A) Pjesëmarrësit

#### • Kriteret për përzgjedhjen e rasteve

Në këtë studim me fëmijë me baba të dënuar do të kuptohen ata individë nën moshën 18 vjeç që gjatë periudhës Korrik – Gusht 2010 kanë pasur babin e tyre të dënuar në IEVP 302 në Tiranë, Shqipëri. Në studim u përfshinë 10 fëmijë, nga të cilët 3 ishin femra. Pjesëmarrësit u intervistuan

në periudhën Korrik – Gusht 2010. Për pjesëmarrjen e tyre u vendosën disa kriteret:

- Të kishin të dënuar sa paku babain e tyre;
- Babai i tyre të vuante dënimin në IEVP 302 në Tiranë, Shqipëri
- Moshë të varionte nga 10 -18 vjeç;
- Të ishin të shoqëruar nga kujdestari i tyre ligjor;
- Të jepnin konsentin e tyre për pjesëmarrjen në studim së bashku me miratimin e kujdestarit ligjor;

Kriteret synonin të përzgjidhnin një kampion sa më përfaqësues, duke qenë e ndërgjegjshme se rezultatet nuk do të mund të përgjithësoheshin.

#### • Njohje me pjesëmarrësit

Në këtë seksion do të ndalemi dhe do njihemi me të dhëna të përgjithshme mbi të fëmijët me baba të dënuar që janë përzgjedhur në këtë studim. Pjesëmarrësit e këtij studimi vijnë si më poshtë (për arsye etike të gjitha të dhënat që mund të identifikojnë personat e këtij studimi nuk jepen të vërteta):

**Mira** është pjesëmarrësja e parë e përzgjedhur për këtë studim. Ajo është 17 –vjeç, me arsim 8-vjeçar. Babai i saj ka 6 muaj që është i arrestuar. Ajo jeton me nënën dhe motrën me te vogël, 10 vjeçe.

**Davidi**, pjesëmarrësi i dytë në këtë studim. Ai është 16 –vjeç dhe ka mbaruar arsimin 8 vjeçar. Jeton me nënën, gjyshen nga ana e babait dhe dy motrat që janë më të mëdha se ai. Jetesa e tyre sigurohet nga pensioni i gjyshes.

**Pjesëmarrësi i tretë** në këtë studim është **Eni**, një i mitur 16 – vjeçar nga Fieri. Është djali i madh i familjes së tij, e cila përbëhet nga prindërit dhe motra e vogël. Eni ka mbaruar vetëm klasën e gjashtë dhe më pas e ka lënë shkollën.

**Antoni**, 12 vjeç është pjesëmarrësi i katërt i këtij studimi. Ai është nga Përmeti. Jeton me gjyshen nga ana e nënës së tij.

**Pjesëmarrësi i pestë** në këtë studim është **Mandi**, një 11 vjeçar. Ai ka mbaruar klasën e gjashtë, por po mendon se dhe mund ta lërë shkollën. Ai jeton në kushte të vështira ekonomike me nënën e tij. Ndërkohë që e motra është vendosur në Shtëpinë e Fëmijëve “Zyber Hallulli” në Tiranë

**Pjesëmarrësi i gjashtë** në këtë studim është **Malvina**, një 16 vjeçare. Ajo jeton me nënën dhe dy motrat më të vogla. Ajo shprehet i indinjuar për dënimin e padrejtë të babis të saj.

**Dorjani**, një 15 vjeçar nga Tropoja jeton me nënën dhe dy vëllezërit më të mëdhenj se ai. Ka mbaruar arsimin 9-vjeçar dhe synon të vazhdojë një shkollë të mesme profesionale.

**Pjesëmarrësi i tetë** në këtë studim është **Altini**, një 10 vjeçar nga Tirana. Altini vazhdon arsimin fillor, por ndërkohë dhe punon paradite duke shitur paketa rrugëve të Bllokut. Ai thekson se kështu bëhet i vlefshëm për familjen e tij, sidomos tani që baba është në burg.

**Pjesëmarrësi i nëntë** në këtë studim është një 17 vjeçar i quajtur **Andi**. Andi ka mbaruar vetëm klasën e parë dhe të dytë të arsimit fillor dhe është nga Tirana. Andit i pëlqen shumë të vizatojë. Është i ndrojtur dhe fjalë pak. Andi i përket komunitetit Rom.

**Pjesëmarrësi i dhjetë** është **Linda**, 14 vjeç nga qyteti i Laçit. Ajo jeton me nënën e saj. Linda ka mbaruar arsimin 9 – vjeçar dhe pret të vazhdojë shkollën e mesme të përgjithshme.

#### B) Hartimi i kërkimit

Ky studim perceptohet si një proces zbulimi dhe jo një testim i thjeshtë i hipotezave. Në këtë kërkim cilësor theksi do i vihet kuptimit të eksperiencave, zakoneve, pritshmërive dhe perspektivës së pjesëmarrësve në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre dhe përcaktimi i nevojave më imediate të tyre.

Ky punim bën pjesë në një sërë mini-studimesh që autorja ka realizuar në përmbushje të studimit të doktoraturës. Gjithashtu, eksperiencia personale me grupet e deprivuar nga liria dhe dëshira e madhe për të sjellë diçka ndryshe, diçka të re në fushën e studimeve, për të kontribuar në zhvillimin e profesionit të punës sociale e nxiti kërkuesen për studimin e një grupi për të cilin nuk kishte shumë të dhëna, siç ishin fëmijët me baba të dënuar. Ky grup shumë i ndryshëm, jo i qëndrueshëm, në kohë dhe hapësirë, u konsiderua si grupi i studimit. Studimi u konceptua që në fillimet e tij si cilësor. Ai do të përfshinte jo vetëm të dhënat që do të merreshin nga pjesëmarrësit, por edhe nga rishikimi i

literaturës mbi teoritë më bashkëkohore të socializmit duke rritur nivelin e kuptueshmërisë për profesionistët dhe më gjerë.

Do të përfshiheshin fëmijë me baballarë të dënuar, jo sepse në Shqipëri nuk ka të dënuara femra, por grupi përfaqësonte një diversitet të madh analizues. Kërkesja shpreh bindjen se në të ardhmen dhe ky grup fëmijësh do të jenë fokus i studimeve të saj.

### C) Instrumentet

Në këtë studim hartimi i instrumenteve është bërë duke u mbështetur në punën e Holstein dhe Gubrium (1995). Janë përdorur “intervistat gjysëm të strukturara” të cilat përqendrohen në teknika aktive dhe jo me pyetje tërësisht të strukturuar. Intervista aktive është “lirshëmrisht i drejtuar”. Ajo konsiston në të dyja elementët, objektive dhe subjektive. Elementët objektive kanë të bëjnë me atë se *çfarë* do të diskutohet në mënyrë të vullnetshme mes të intervistuarit dhe intervistueses. Është subjektive sepse ndikon se si intervistuesit do e interpretojnë “atë që duan intervistuesit dhe kanë mundësi të zhvillojnë mendimin e tyre mbi këtë perceptim, që mund të jetë edhe i gabuar”. Gjatë realizimit të intervistave është mbajtur një format pyetjesh të ndërtuara nga kërkesja në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij kërkimi.

Ky studim është bazuar edhe në studimin e literaturës në lidhje me objektin kryesor të saj. Në përzgjedhjen e literaturës, kanë dominuar katër kritere, të cilat janë marrë në konsideratë.

- Autenticiteti, është origjina e burimit të vërtetë;
- Kredibiliteti, përfshin shmangien e çdo gabimi ose manipulimi të mundshëm;
- Përfaqësues, është burimi tipik në llojin e tij;
- Kuptimi, është burimi i qartë dhe gjithëpërfshirës;

### D) Procedura

Pas prezantimit, të intervistuarve ju është bërë e qartë qëllimi i intervistës dhe çështjet e konfidencialitetit. Më pas u është kërkuar konsenti/miratimi me shkrim i tyre për të qenë pjesë e këtij studimi. Pasi ata kanë dhënë konsentin e tyre, ka filluar intervista.

Pyetjet janë bërë në përputhje me linjën logjike që intervista merrte ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit. Qëllimi i intervistës ishte të lejonte të intervistuarin të paraqiste historinë e tij me ndërhyrje minimale nga intervistuesi. Janë drejtuar të gjitha pyetjet e përfshira në format, jo gjithmonë sipas renditjes së tyre, dhe shumë pyetje të tjera për të cilat intervistuesja ishte e interesuar të merrte opinionin, mendimin dhe perceptimet e të intervistuarve.

Pjesëmarrësit janë intervistuar vetëm një herë për pothuajse 90 minuta. Atyre u është kërkuar të tregojnë historinë e tyre të bazuar në çështjet kryesore të intervistës. Intervistat janë zbardhur në të ashtuquajturat narrativa. Analizimi narrativ është hallka e parë e analizimit të intervistave. Ajo përdoret për të interpretuar të dhënat. Narrativat janë përshkruar nga Gubrium dhe Holstein (1997) si “llogari që ofrojnë disa skema, në mënyrë implicite ose eksplicite, për organizimin dhe kuptimin e marrëdhënive mes objekteve dhe ngjarjeve të përshkruara”. Narrativat na ndihmojnë në procesin e kodimit. Në këtë studim është përdorur procesi i kodimit të hapur, në të cilin konceptet përzgjidhen dhe përshkruhen në bazë të dimensioneve dhe karakteristikave të tyre. Në këtë studim është përdorur kodimi i fjalive dhe paragrafëve. Kategoritë fillestare janë zhvilluar më tej në lidhje me rrethanat shkakësore, pasojat, kontekstin, veprimin dhe ndërveprimin dhe faktorëve ndërhyrës. Së fundmi, është përdorur kodimi selektiv në mënyrë që të konsolidohen dhe të integrohen rubrikat kryesore të studimit. Kategoritë e identifikuar kishin të bënin me këto elementë të socializimit:

- Stigmën dhe turpin;
- Izolimin social;
- Nevojat ekonomike.

Në këtë studim ju është kushtuar vëmendje e rëndësishme këtyre *principeve etike*:

- *Konsenti i informuar* sipas Terre Blanche dhe Durrheim (1999) dhe Strydom (2002) është procesi i kërkimit të lejes në mënyrë eksplicite subjektit për të qenë pjesëmarrës në studim,

bazuar në kuptueshmërinë e plotë të tij mbi procedurat e intervistimit dhe qëllimit të tij. Për shembull, të gjithë pjesëmarrësve në këtë studim iu është bërë e ditur qëllimi i intervistës dhe fakti i mbajtjes shënim i intervistës. Ata janë lejuar që t'i lexojnë shënimet në çdo moment të intervistimit.

- **Konfidencialiteti** përfshin një marrëveshje nga kërkuesi për të mbrojtur anonimatën e pjesëmarrësve në studim (Stydom, 2002). Shumë pak njerëz do të donin të ndanin me të tjerët detaje të jetës së tyre private, opinionet dhe emocionet e tyre. Për këtë arsye konfidencialiteti është një kërkesë e domosdoshme për kërkime të besueshme (Oka dhe Shaw, 2000).

- **Raportimi i rezultateve:** Rezultatet e studimit duhen publikuar duke treguar shumë kujdes mbi të drejtat e pjesëmarrësve. Në asnjë moment nuk duhen keqinterpretuar apo shtrembëruar informacioni i dhënë nga pjesëmarrësit në studim (Stydom, 2002). Në këtë studim, rezultatet mbështeten plotësisht në të dhënat e marra nga pjesëmarrësit.

### III. REZULTATET

#### A. Fëmijët dhe baballarët e tyre.

##### 1. Stigma dhe turpi.

Ajo çfarë përjetojnë fëmijët me baba të dënuar, ka qenë pjesë e shumë studimeve në botë. Në Shqipëri, fatkeqësisht, akoma nuk është bërë një studim i mirëfilltë në lidhje me një çështje të tillë. Kërkuesja i pyeti fëmijët e intervistuar në lidhje me këtë çështje. Këndvështrimet dhe problemet me të cilat ishin përballur fëmijët ishin të shumta. Ata dëshmojnë për paragjykime, përbuzje, mbyllje në vetvete, etj.

Fëmijët e intervistuar dëshmojnë se që nga momenti i arrestimit të babait të tyre, në komunitetet ku ata jetojnë gjykohen dhe nuk mirëprehen. Shumë shpesh ata janë etiketuar, jo vetëm nga bashkëmoshatarë të tyre, si "kriminelë", "burgaxhinj" dhe "të padëshiruar". Mandi, shprehet:

*"Kur ika në shkollë, mësuesja se si më pa...ndërsa shoqja e klasës ishte larguar dhe në bankë më*

*kishin shkruar "kriminel". Nuk di ta përshkruaj sesi u ndjeva..."*

Ndërsa, Altini thekson:

*"Nuk dua ta kujtoj fare situatën e të nesërmes...babai im kishte bërë një krim të tmerrshëm, por ne nuk kishim faj. Kur dola në rrugë, më gjuajtën me gurë dhe më shanë me fjalë nga më të ndryshmet".*

##### 2. Izolimi social

Shumë shpesh, ajo çfarë raportohet nga studimet është dhe fakti që fëmijët e të dënuarve jo vetëm që mbyllen në vet-vete, por si rezultat i stigmës ata izoloohen nga bota e jashtme. Një fakt i tillë, raportohet edhe nga të intervistuarit taë. Kështu, Mira shprehet:

*"Kur babi u dënua, nuk doja të dilja. Mbaj mend se kam qëndruar 50 ditë e mbyllur brenda, vetëm me mamin dhe motren. Shpesh herë nuk doja të flisja edhe me ato."*

Malvina, Drojani dhe Linda dëshmojnë të njëjtën gjë.

##### 3. Nevojat ekonomike.

Fakti që babi dënohet nuk do të thotë domosdoshmërisht që fëmijët të humbasin të drejtën për përkujdesje. Në shoqërinë tonë, ku marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes vazhdojnë të jenë i vetmi burim përkujdesjeje dhe figura atësore perceptohet si kryesoja për sigurimin e të ardhurave, mungesa e tij sjell për pasojë moskujdes për fëmijët. Institucionet shtetërore mbi përkujdesjen e fëmijëve të prindërve të dënuar duhen forcuar. Mandi, 11 vjeç tregon:

*"Në shtëpinë time vetëm babi punonte. Kur ai u dënua ne nuk kishim me çfarë të jetonim. Mami u detyrua ta çonte motrën e vogël në jetimore. Unë punoja me të duke fshirë rrugët e Tiranës natën. Ditën shkoj në shkollë, po nuk është se mësoj shumë. Ndonjëherë më zë edhe gjumi në klasë. Po mami ka nevojë për mua."*

##### B. Çështje teorike mbi socializimin

Vëmendja më e madhe nëpër studime i është dhënë faktit nëse fëmijët me prindër të burgosur do të shfaqin sjellje kriminale, për të testuar hipotezën nëse vetë krimi është i trashëguar (Wilson & Herrnstein, 1985).

Në një rishikim të kohëve të fundit të kërkimeve gjenetikë mbi krimin, Christopher Jencks (1992) thekson se njohuritë tonë mbi krimin dhe shkaqet e tij, janë primitive. Pothuajse të gjitha këto studime janë realizuar vetëm me meshkuj. Jencks thekson se nëse ka një predispozitivë gjenetike që ndikon në shfaqjen e sjelljes kriminale, ajo mund të shikohet si një kombinim i tyre me faktorë të tjerë shoqërorë që mund të përfshijnë reagimin shoqëror ndaj krimit dhe padyshim, reagimin e vetë shtetit me anë të sanksioneve penale. Pra, pa marrë parasysh supozimet nëse krimi është i lindur apo i mësuar, neve jemi të shqetësuar për lidhjen që ekziston mes dënimit të prindërve dhe shfaqjes së akteve kriminale tek fëmijët e tyre.

### **Studimet e Mëparshme**

Shumë pak dihet se si ndikon dënimi i prindërve në jetën e fëmijëve (Gabel, 1992). Për shembull, shumë pak është e njohur mënyra se si ndikojnë komponentët të tillë si raca dhe gjinia e prindërve në ruajtjen, vazhdimësinë dhe konsolidimin e marrëdhënieve mes tyre dhe fëmijëve. Ndërkohë që variabli i moshës së fëmijës shpesh herë nuk konsiderohet.

Megjithatë, ka pasur relativisht pak studime me fokus nevojat e fëmijëve me prindër të dënuar. I pari ndër këto studime u përqendrua në problemet financiare dhe përshtatjen e tyre pas dënimit të njërit/të dy prindërve. (Bloodgood, 1928). Gabel (1992) identifikoi disa tema të tjera në evoluimin e kësaj çështjeje duke përfshirë edhe traumat që shoqërojnë këtë ndarje, problemet e kujdesit, stigmën dhe sjelljet antisociale. Studimi më i njohur i kësaj fushe është bërë nga Sack dhe kolegët, të cilët kanë studiuar mostrat klinike dhe jo klinike të fëmijëve me prindër të dënuar (Sack, 1977, Sack, Seidler, dhe Thomas, 1976, 1978). Këto studime raportojnë se fëmijët identifikojnë si probleme kryesore

stigmën dhe izolimin social. Sack dhe kolegët identifikuan gjithashtu dhe lidhjen mes burgosjes së prindërve dhe shfaqjes së sjelljeve antisociale të fëmijëve të tyre (Bakker, Morris, dhe Janus, 1978; Fritsch & Burkhear, 1981, Lovenshtein, 1986,).

Gabel (1992) tregohet më kritik ndaj studimeve ekzistuese duke vënë në dukje se studimet e deritanishme kanë tendencën të jenë "...Përshkruese dhe anekdotike, me disa studime empirike dhe kufizime metodologjike të theksuara". Gabel është i shqetësuar se këto studime nuk kanë përfshirë jetën e fëmijëve dhe familjarëve të tyre përpara burgosjes së prindit/prindërve dhe se nuk ka studime afatgjata që mund të përshkruajnë ndryshimet reale që kanë ndodhur në jetën e fëmijëve si rezultat i kësaj ngjarjeje. Ai shkruan se, "ndryshimet e rëndësishme në sjellje, jetën familjare dhe sociale, si dhe të dhënat e ligjore në pjesën më të madhe të këtyre studimeve janë lënë pas dore dhe nuk janë trajtuar."

Gabel përfundon shqyrtimin e tij duke theksuar nevojën urgjente për studime të reja dhe të hartuara mirë dhe me fokus fëmijët e prindërve të dënuar, duke vënë në dukje se "fëmijët e prindërve të dënuar meritojnë më shumë studime dhe vëmendjen e politikave publike, sepse ata janë një grup me risk të lartë për tu përfshirë në sjellje atnisociale dhe se gjithashtu janë një grup që sa po vjen dhe po bëhet më i madh".

### **Perspektivat sociologjike dhe kriminologjike mbi efektet e burgimit prindëror mbi fëmijët.**

Burgimi i njërit prej prindërve mund të ndryshojë perspektivën e familjes në shumë mënyra; e bën që ajo të ri-funksionojë si një familje me një prind të vetëm (shih McLanahan & Sandefur, 1994), ose mund ta perceptojmë si një familje e cila e vuan këtë fakt ashtu sikurse u përshkrua dhe më lart. Gjithsesi, ajo që vihet re është se trauma e burgimit prindëror mund të ketë dimensione ekonomike, sociale dhe emocionale. Teoritë sociologjike dhe kriminologjike i kanë përshkruar efektet e burgimit prindëror mbi fëmijët në tri mënyra. Këto përfshijnë tensionet e privimi

ekonomik; humbjen e socializimit prindëror nëpërmjet modelimit të rolit, mbështetjes dhe mbikëqyrjes, dhe stigmës e turpit nëpërmjet etiketimit shoqëror. Të tri perspektivat përfshijnë supozimet mbi pasojat e largimit ose heqjes së prindërve nga shtëpia.

**Perspektiva e Tendosjes Ekonomike.** Nëse një prind i burgosur ka kontribuar më parë pozitivisht në familje, që me burgimin e tij mund të vihet re privimi ekonomik dhe presione të tjera që ndikojnë në jetën e fëmijëve. Efektet e privimit të prindërve mund të jenë të tërthorta, si dhe të drejtpërdrejtë, që përfshijnë humbjen e të ardhurave që prindi i burgosur mund të ketë dhënë dhe kontributin më pak të prekshëm, por jetikë që prindërit në fakt përbëjnë jetën familjare në përgjithësi (McLanahan & Bumpass, 1988). Prindërit e mbetur, ata jo të dënuarit, kanë më pak kohë, si dhe më pak para për të investuar tek fëmijët e tyre në mënyrë sociale dhe ekonomike (McLanahan & Sandefur, 1994). Është e rëndësishme që të njohin, pra, se tërheqja ose humbja e një prindi mund të rezultojë në uljen jo vetëm të kapitalit ekonomik, por edhe i kapitalit shoqëror e marrëdhënieve mes anëtarëve të familjes dhe organizimit të jetës familjare në drejtim të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të mundësive për një jetë më të mirë. Këto marrëdhënie kanë implikime emocionale dhe në të përditshmen praktike. Për shembull, fëmijët më të mëdhenj mund të marrin përgjegjësi të papritura të tilla si kujdesin për fëmijët më të vegjël. Ato gjithashtu mund të largohen nga shkolla dhe të përfshihen në veprimtari pune për të plotësuar të ardhurat familjare. Nga ana tjetër, këto të rinjtë mund të shkojnë drejt ekonomisë së paligjshme dhe veprimtarive kriminale ose martesë të hershme si pretekste për tu larguar nga jetë e vështirë familjare.

**Perspektiva e Socializimit.** Për shumë vjet, socializimi mes prindërve dhe fëmijëve është shikuar si një proces me një drejtim. Fëmijët konsideroheshin si produkt i teknikave socializuese të prindërve të tyre. Megjithatë, sot

ne e shikojmë ndërveprimin prind – fëmijë si reciprok<sup>26</sup>. Socializimi i dyanshëm përfshin socializimin dydrejtimësh; fëmijët socializojnë prindërit sikurse prindërit socializojnë fëmijët. Vetë socializimi përkufizohet si procesi i të bërit njeri; i të mësuarit të rregullave, vlerave dhe normave kulturore të një shoqërie të caktuar, ku vetë individi bën pjesë. Për shembull, ndërveprimi mes nënës dhe fëmijës është simbolizuar me kërcimin ose dialogun në të cilin veprimet e mëtejshme janë saktësisht të koordinuara. Ky kërcim ose dialog i koordinuar pranon formën e sinkronizimit të dyanshëm (sjellja e çdo personi varet nga sjellja e mëparshme e prindit). Ose mund të jetë reciproke në sens më preciz; veprimet e partnereve mund të harmonizohen, sikurse kur njëri partner imiton tjetrin.

Kur u studiuua socializimi i dyanshëm në foshnjëri, u gjet se kontakti i dyanshëm me sy luan një rol të rëndësishëm në ndërveprimin e hershëm social. Në një studim, nëna dhe foshnja përfshiheshin në sjellje të ndryshme gjatë kohës që shikoheshin në sy; në të kundërt, kur ata humbitnin kontaktin me sy me njëri – tjetrin, shkalla e sjelljeve të tilla binte në mënyrë të konsiderueshme. Si përfundim, mund të themi se sjelljet e nënës dhe fëmijës përfshijnë kontakte të konsiderueshme, rregulla të dyanshme dhe të sinkronizuara.

Shumë autorë përshkruajnë rolin e rëndësishëm të kujdestarit në ndërveprimin e hershëm prind – fëmijë. Përmes vëmendjes dhe zgjedhjes së sjelljeve, kujdestarët mundësojnë një kornizë rreth së cilës atë dhe fëmijët e tyre ndërveprojnë. Tërësia e rregullave shërben veçanërisht për të njohur fëmijët me rregullat sociale.

Përsëri, duke supozuar si të vërtetë se prindi i burgosur ka kontribuar pozitivisht në jetën e familjes, burgimi mund të privojë familjen nga një burim i rëndësishëm për socializimin e fëmijës. Studimet sociologjike dhe teoritë e kriminologjike zakonisht theksojnë rëndësinë e mbikëqyrjes prindërore, modelimit të rolit dhe mbështetjes

<sup>26</sup> Schaeffer, C., & Briesmeister, J. (Eds.). (1989). *Handbook of parent training: Parents as co-therapists for children's behavior problems*. New York: John Wiley.

për zhvillim. Kjo perspektivë është pasqyruar më dukshëm në teoritë e kontrollit të kimit dhe të devijimit social. Versioni më i shquar i teorisë së kontrollit pohon se edhe prindërit dhe vëllezërit e motrat që janë të orientuar në aktivitete kriminale, shpesh mund të orientojnë dhe anëtarët më të rinj të familjes në këto aktivitete (Hirschi, 1969).

Teoria e kontrollit në studimin e kimit është hulumtuar gjatë nga Sampson dhe Laub (1993), të cilët theksojnë se kontrolli social i fëmijëve nga prindërit është një burim i rëndësishëm i kapitalit social, që ndikon gjatë gjithë jetës.

Heqja/largimi i një prindi nga familja mund të ndikojë te fëmijët në mënyra të ndryshme. Fëmijët ndjehen të humbur dhe jashtë çfarëdo mbikëqyrjeje dhe mbështetjeje (McLanahan & Bumpass, 1988).

**Perspektiva e Stigmatizimi.** Kriminologët i kanë kushtuar vëmendje të veçantë burgimit të babait si një njollë që i kushton familjarëve dhe sidomos fëmijëve të tyre. Stigmatizimi rrit vunerabilitetin e fëmijëve të të dënuarve pasi kë për qëllim përjashtimin nga grupi shoqëror i fëmijëve të të dënuarve.

Braithwaite (1991) thekson se këta fëmijë akumulojnë ndjenja zemërimi si rezultat i trupit dhe refuzimit. Scheff dhe Retzinger (1991) shpjegojnë se shkolla, prindërit, punëdhënësit, dhe gjithnjë e më shumë qytetarë njohin një numër të madh të rinjsh të zemëruar që janë gati në shpërthime emocionale nëpërmjet zemërimit si përgjigje ndaj fyerjeve të së kaluarës.

Stadeti Zhvillimore	Karakteristika Zhvillimore	Detyrat Zhvillimore	Faktorë Ndikues	Efektet
Fëmijëria (0 – 2 vjeç)	Varësi e plotë	Atashim dhe besim	Ndarja prind – fëmijë	Kufij të dobët prind – fëmijë
Fëmijëria e hershme (2-6 vjeç)	Rritje e perceptimit dhe lëvizjeve; i paplotë individualizimi nga prindi	Ndjenja e autonomisë, pavarësisë dhe iniciativës	Ndarja prind – fëmijë Traumë	Ankth, regresion në zhvillim, stres akut traumatik, fajësim i mbijetesës
Fëmijëria e mesme (7 – 10 vjeç)	Rritje e pavarësisë, aftësisë për të arsytuar, rëndësi ndaj bashkëmoshatarëve.	Ndjenja e aftësisë për të punuar në mënyrë produktive	Ndarja prind – fëmijë Traumë e fortë	Stres akut traumatik dhe sjellje agresive
Adoleshenca e hershme (11 – 14 vjeç)	Zhvillim i të menduarit abstrakt, sjellje të orientuara nga e ardhmja, agresion, pubertet.	Aftësi për të punuar në mënyrë produktive me të tjerët, kontroll i emocioneve	Ndarja prind – fëmijë Traumë e fortë	Refuzim i limiteve në sjellje, sjellje agresive.
Adoleshenca e vonë (15 – 18 vjeç)	Kriza emocionale dhe konfuzitet, zhvillimi seksual prej të rriturit, pavarësi në të menduarin abstrakt	Arritje e identitetit, përfshirja në punë dhe marrëdhënie me të rriturit, zgjidhje e konflikteve me familjarët dhe shoqërinë.	Ndarja prind – fëmijë Traumë e fortë	Fund i parakohshëm i marrëdhënies prind-fëmijë; përfshirje në krim dhe burgim

**Tabela 1.** Efektet mbi Fëmijët e të Dënuarve, Arrestuarve



#### IV. DISKUTIMI

Duke qenë një studim i pari në llojin e tij, kërkuesja synon jo vetëm të përmbushë qëllimet dhe objektivat e këtij studimi, por dhe të sjellë një konceptualizim të ri të profesionit të punës sociale dhe me fëmijët e të dënuarve. Nevojat e tyre janë të shumta, mosplotësimi i tyre ndikon drejtpërdrejtë në mënyrën e të sjellurit, menduarit dhe të vlerësuarit të jetës dhe vetes në veçanti. Të gjithë këto komponentë ekonomikë, psikologjikë dhe socialë duhen konsideruar sepse kur flasim për fëmijët si e ardhmja e shoqërisë nuk përmendim thjesht vetëm një klishe.

Fëmijët me baba të dënuar sjellin këndvështrimin e tyre mbi të drejtat që edhe ata duhet të gëzojnë, pavarësisht statusit të babait të tyre. Rezultatet e këtij studimi do të shërbejnë për të ri-konceptualizuar praktikën shqiptare të punës sociale me fëmijë me baba të dënuar.

#### Efektet e Burgimit të Prindërve të Fëmijët

Megjithëse vihet re një tendencë përgjithësimi mbi ndikimin tek fëmijët e burgosjes së prindërve, përgjigjet aktuale të fëmijëve janë të ndarë nga faktorë që janë unike për situatën e tyre, duke përfshirë gjininë e prindit, moshën në të cilën ndarja ka ndodhur, dhe kohëzgjatjen e dënimit. Gjinia e prindit të dënuar është një faktor domethënës që tenton të ndikojë në mënyrën se si fëmijët do t'i përgjigjen burgosjes. Në lidhje me gjininë e fëmijës, përgjigja e fëmijës që vuan burgosjen e nënës mund të karakterizohet si sjellje "frenuese", si e qara dhe tërheqje emocionale. Burgosja e baballarëve në përgjithësi provokon në sjelljen e fëmijëve karakteristika "vepruese", që përfshijnë largimin nga mësimi dhe arratisje nga shtëpia (Fritsch and Burkhead 1981). Moshë në të cilën ndodh ndarja prind-fëmijë është faktori i dytë që ndikon në përgjigjet e fëmijëve përkundrejt burgosjes. Në përgjithësi, ndarja është më e dhimbshme kur fëmija është i vogël. Fatkeqësisht të dhëna e deritanishme, të cilat janë të përqendruara në popullsinë femërore në burgje, tregojnë se më shumë se 2/3 e fëmijëve janë më të vegjël se 10 vjeç dhe rreth çereku i tyre kanë qenë më të

vegjël se 4 vjeç në momentin kur nëna e tyre është burgosur. Kjo gjetje është interesante sepse ilustron që pjesa më e madhe e eksperiencave të ndarjes së fëmijëve në mënyrë specifike nga nënat e tyre ka ndodhur gjatë fëmijërisë së hershme ku një marrëdhënie natyrore pozitive është esenciale për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve (McGowan and Blumenthal 1978). Gjatësia e dënimit dhe ndarja mes fëmijëve dhe prindit është një faktor tjetër i cili tenton të shpjegojë se si fëmijët i përgjigjen burgosjes së prindit. Burgosja ka më pak efekte negative dhe është më pak përcarëse për ata fëmijë të cilët kanë kontakte të vazhdueshme me prindin e dënuar. Dy janë faktorët që duhen konsideruar kur kjo ndodh. *E para*, kontaktet e rregullta kanë më shumë mundësi të ndodhin kur fëmijët vazhdojnë të jetojnë me anëtarët e tjerë të familjes se sa në rastet kur ata bëhen pjesë e sistemit të kujdestarisë (McGowan and Blumenthal 1978). *Së dyti*, kontaktet ndodhin më shpesh kur prindi i dënuar vendoset në një institucion që është relativisht afër me qendrën e banimit të fëmijës. Megjithatë, rreth 60% e prindërve të dënuar dhe 80% prindërve të paraburgosur janë vendosur në institucione që kanë një distancë më shumë se 100 km nga rezidenca e fëmijëve (Mumola 2000). Kështu, këto barriera strukturore, si distanca, shpesh bëjnë që vizitat në burgje dhe si rrjedhim komunikimi i qëndrueshëm të bëhen të pamundura. Edhe për fëmijë të cilët kanë kontakte të qëndrueshme me prindit e dënuar, shumë sfida paraqiten kur prindi kthehet në shtëpi. Së bashku, fëmijët dhe prindi duhet të punojnë fort për të rivendosur marrëdhënien e tyre dhe të tejkalojnë çfarëdo lloj pengese që ka ardhur si rezultat i ndarjes së tyre (Travis and Waul 2004). Vështirësitë nuk kanë mbaruar akoma. Lejet apo ri-dënimi i prindit sjell rivendosje dhe riorientim të marrëdhënies. Recidivizmi është një proces me mundësi të mëdha që të ndodhë tek të ish-të dënuarit. Kështu, recidivizmi shfaqet më shumë tek burrat se sa tek gratë.

Dr. Denise Johnston, Drejtori i Qendrës së Fëmijëve me Prindër të Dënuar, ka studiuar

efektet e dënimit të prindërve tek fëmijët. Puna e tij është përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

## V. REFERENCAT

- Braithwaite, John (1991) *Crime, Shame and Reintegration*: Sage Publication
- Bryman, A. (2001) *Social Research Methods*, Oxford: Oxford University Press
- Devine, F. "Qualitative Methods" in Marsh, D and Stoker, G (ed) (1995) *Theory and Methods in Political Science*, Houndmills: Palgrave
- Dragoti, Edmond. et. al. (1996) *Puna Sociale*. Tiranë: TOENA.
- Dragoti, Edmond (1999). *Adoleshenti. Vështrim socialpsikologjik i fillimeve të Adolehencës*. Tiranë: ALBDESIGN.
- Fantuzzo, J. & Lindquist, C. (1989). The effects of observing conjugal violence on children: A review & analysis of research methodology. *Journal of Family Violence*, 4(1), 77-94.
- Fritsch, T.A., and J.D. Burkhead. "Behavioral Reactions of Children to Parental Absence Due to Imprisonment." *Family Relations* 30, 1981.
- Gubrium, Jaber F. & Holstein, James A. (1997). *The New Language of Qualitative Method*. New York: Oxford: Oxford University Press
- Gabel, Katherine and Denise Johnston (1995). *Children of Incarcerated Parents*. New York: Lexington Books.
- Susan M. Hunter (1980) "Forward," in Gabel and Johnston.
- Katz, Pamela Covington (1998) "Supporting Families and Children of Mothers in Jail: An Integrated child Welfare and Criminal Justice Strategy." *Child Welfare League of America*.
- Lowenstein, Ariela. "Temporary Single Parenthood—The Case of Prisoners' Families." *Family Relations* 1986
- Mumola, Christopher. *Incarcerated Parents and Their Children*. Washington DC: U.S. Department of Justice, 2000.
- Schaeffer, C., & Briesmeister, J. (Eds.). (1989). *Handbook of parent training: Parents as co-therapists for children's behavior problems*. New York: John Wiley.
- Travis, Jeremy and Michelle Waul. *Prisoners Once Removed*. Washington DC: The Urban Institute Press, 2000..